



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës * Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 715/24 Dt. 20.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, konform kërkesës së OE "TOSI-V SH.P.K & N.P AUREMONT" dhe kërkesës (raportit) të Menaxherit të Kontratës, për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: "Renovim i banesave kolektive sociale në lagjen Petrovë (kulla 3 Petrovë) projekt 2 vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 25,800.00 € (njëzet e pesë mijë e tetëqind euro).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t'i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-24-4098-5-2-1/C1435.
3. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Sektorit të Prokurimit,
 - Arkivës së Kryetarit.

